












# Paketa per viktimen
## Keshilla dhe udhezime





## Permbajtja


Hyrje 3

Te dhenat e oficerit dhe te informacionit te dobishem 3

Premrimi yne per ju 4

Ç'mund te pritet 6

Shenime 8

Pyetje tuaja te pergjigjura 8

Nese jeni te pakenaqur 11

Numra telefoni te dobishem 12






# Hyrje

Policia e Humberside-it angazhohet te jep sherbim me te mire publikut ne lidhje me hetimin e shkeljeve krminale.

Kjo mbase eshte hera e pare qe keni te beni me policine. Ne e kuptojme se ky eshte moment i veshtire per ju, prandaj ne kemi siguruar kete broshure e e cila permban detajet e pyetjeve te shtruara me se shpeshti dhe ju jep informacion se ku duhet te veni qe te merrni ndihme dhe keshilla. Ne faqen 8 eshte nje hapesire ku mund t'i regjistroni shenimet tuaja.

## Informacion i dobishem per ju

| | |
|---|---|
| Numri referues i incidentit | |
| Numri referues i krimit | |

| | Emri | Numri identifikues | Data e vijimit |
|---|---|---|---|
| Oficeri Raportues | | | |
| Hetuesi i skenes se krimit | | | |
| Oficere tjere | | | |
| | | | |
| | | | |

Ju mund te kontaktoni oficerin i cili mirret me incidentin tuaj duke e thirrur numrin 0845 60 60 222.

Ne shpresojme se broshura do te jete e dobishme , por nese keni pyetje tjera ju lutem kontaktoni oficerin te dhenat e te cilit mund ti gjeni me larte. Perndryshe, ju mund ta thirrni ate ne numrin 0845 60 60





# Premtimi yne per ju
# Premtimi i patrullimit

## Kurdo qe vini ne kontakt me Policine e Humberside-it, ju pritni t'i merrni keto sherbime:

- Gjithmone trajtojme komunitetet tuaja me drejtesi dhe me dinjitet dhe respekt duke u siguruar se komunitetet tona kane te drejte t'i perdor in sherbimet tona kur jane te arsyeshme dhe te pershtatshme per to.
- Sigurojme komun itetet tona me informacion ne menyre qe ta dine ata se kush eshte Ekipi i dedikuar i Patrullimit te Lagjes, ku e kane bazen, si te kontaktohen dhe si te punohet me ta.
- Sigurojme se Ekipi yne i Patrullimit te Lagjes dhe patrullimet tjera policore jane te dallueshme dhe me shenja atehere kur duhet te jene me efektive dhe kur i nevojiten komuniteteve tona me se shumti. Ne do te sigurojme se ekipet tona nuk do te largohen nga puna ne lagje me shume se sa eshte e nevojshme. Ne do te kalojme se paku 80% te kohes tone duke punuar dallueshem ne lagje, duke i trajtuar prioritetet lokale. Qarkullimi i personelit do te minimalizohen.
- Pergjigjemi çdo mesazhi te drejtuar ekipit tone te Patrullimit te Lagjes brenda 24 oreve dhe, ku eshte e nevojshme te sigurojme pergjigje me te hollesishme sa me shpejte.
- Synojme t'i pergjigjemi thirrjeve 999 brenda 10 sekondave, duke shperndare personelin ne raste urgjente menjehere, duke e dhene kohen e perafert te ardhjes, ardhjen e tyre te sigurte dhe sa me te shpejte. Ne zona urbane, ne synojme te mbrrijme ne komunitetet benda 15 minutave dhe ne zonat rurale brenda 20 minutave.
- Pergjigjemi shpejte ne te gjitha llojet e thirrjeve jo urgjente. Nese nevojitet prania e jone, te dergojme patrullen duke e dhene kohen e perafert te ardhjes se tyre dhe:

- Nese personi eshte i ndijshem apo i shqetesuar synojme te jemi me personin brenda 60 minutave

. Nese personi telefonon per ndonje çeshtje per te cilen ne jemi pajtuar se komunitetit i tyre do te jete lagje prioritare dhe prania eshte e nevojshme, ne do te synojme te jemi me ate person brenda 60 minutave

Si alternative, nese eshte e duhur, ne do te caktojme nje takim per ti pare ata ne nje kohe qe ju pershtatet atyre brenda 48 oreve

Nese pajtohemi se prania nuk eshte e nevojshme ne do t'ju jepim atyre keshilla, pergjigjemi pyetjeve te tyre dhe/ose i vejme ne kontakt me dike qe ju ndihmon.

- Caktojme takime te rregullta publike per t'u pajtuar me prioritete lokale nje here ne muaj, duke i dhene rast komuniteteve ta takojne ekipin e tyre lokal me anetar te tjere te komunitetit. Keto do te perfshijne mundesite siç jane dhome- vizitat, udhezimet ne rruge dhe vizitat ne stacione policore mobile te cilat do te caktohen per te ofruar nevoja dhe kerkesa lokale.
- Sigurojme informacion te fresket mujor te progresit , ne krimet lokale dhe çeshtjet e patrullimit. Kjo perfshine provizionin e hartave te krimit, informacion ne krimeve te veçanta dhe çfare ndodh me ata qe dalin para igjit, hollesirat se çfare masa marrim ne dhe parneret tane per t'i bere lagjet me te sigurta dhe informacion se si do te performoj forca jone.





- Nese nje person ka qene viktim e krimit, ne do te pajtohemi me ta se sa here deshirojne te informohen per progresin e rastit te tyre dhe per sa kohe. Ata kane te drejte te informohen se paku nje here ne muaj dhe per aq kohe sa eshte e arsyeshme.
- Pranojme çfaredo pakenaqesie me sherbimet brenda 24 oreve te cilat jane raportuar tek ne. Per t'na ndihmuar ta zgjidhim çeshtjen , diskutoni me ta se si do te arrihet kjo, jepni mundesi te bisedojne me dike personalisht lidhur me shqetesimet e tyre dhe merruni vesh me ta se çfare do te behet me to dhe sa shpejte do te behet kjo.

## Ne do te bejme çmos per komunitetitet tona, por nese nuk i plotesojme premtimet tona ne gjithmone do t'ju shpjegojme pse nuk eshte arritur kjo ne kete rast ne nivel te larte ashtu siç aspirojme ne dhe ashtu siç e meriton publiku.

Policia e Humberside-it nuk do te toleron asnje forme te urrejtjes se krimit dhe ne jemi te angazhuar t'ju ofrojme siguri pavaresisht nga raca, besimi, status imigracioni, orientim seksual, kultur ose paaftesi.

Çdo zone policore ka nje Oficer Kohezioni te Komunitetit i cili punon me komunitetin dhe agjencione tjera ne lokalitetin e tyre te inkurajojne raportimin e urrejtjes se krimit dhe te sigurohet trajtimi i viktimave me sensitivitet. Ju mund te flisni me nje oficer lokal me konfidence te plote dhe te gjitha masat pasuese do te mirren ne dobine tuaj dhe me pelqimin tuaj.

**Per informacion te metutjeshem kontaktoni Kordinatorin e Urrejtjes se Krimit ne numrin e telefonit 01482 578194**








## Ç'mund te pritet

Varesisht nga lloji i krimit dhe rrethanave, juve do t'ju vizitoj nje polic apo nje anetar i trajnuar i personelit.

## Shpjegimi i pare

Kur vjen oficeri per t'ju vizituar ata duan t'ju pyesin se çfare ka ndodhur. Ne e quajme kete shpejgim i pare. Ata do te deshirojne te marrin sa me shume te dhena lidhur me incidentin.

## Te dhenat

Oficeri do te ekzaminoj vendngjarjen nese eshte e duhur, dhe do te ruaj çfaredo faktesh qe i gjejne. Ndonjehere oficeri deshiron te flas me miqt ose fqinjte per te zbuluar nese kane pare ose degjuar ndonje gje lidhur me incidentin, qe mund t'ju ndihmoj atyre me hetimet e tyre. Hetuesi i vendngjarjes se krimit , i cili eshte i trajnuar per prova te mjekesise ligjore,, mund t'ju vizitoj dhe te kryej ekzaminimin e vendngjarjes, nese duhet te behet kjo.

## Prona personale

Nese ju kane grabitur ose ju kane vjedhur ndonje prone, oficeri do te regjistroj ne hollesira se çfare prone eshte vjedhur. Ju dueht te perfshini sa me shume hollesira ne menyre qe t'i ndihmoni policise te indentifikoj dhe kthej ndonje prone personale te rigjetur. Te dhenat perfshijne numrat serik ose te modelit, nese i keni.

Nese deshironi te freskoni listen e prones suaj ju mund te thirrni **0845 60 60 222**







## Hetimet dere me dere

Ndonjehere oficeri ka nevoje te flas me miqt ose fqinjte per te zbuluar nese kane pare ose degjuar ndonje gje lidhur me incidentin, qe mund t'ju ndihmoj atyre me hetimet e tyre.

## Parandalimi i krimit

Oficeri mund t'ju jep keshilla te pergjithshme lidhur me parandalimin e krimit kur ju viziton. Nese deshironi me shume informacion ju mund te vizitoni uebsajtin e Policise se Humberside-it **www.humberside.police.uk**,perndryshe ju mund te gjeni keshilla duke vizituar uebsajtin e Home Office-it ne parandalimin e krimit **www.homeoffice.gov.uk**

## Deklarata Personale e Viktimes

Nese keni deshire ju mund te beni nje Deklarate Personale te Viktimes, e cila ju jep rast te tregoni se si ka ndikuar krimi ne ju, per shembull, fizikisht, emocionalisht apo financiarisht. Kjo e shton informacionin qe tashme i keni dhene policies ne deklaraten tuaj lidhur me krimin. Deklarata Personale e Viktimes do te behet pjese e rastit dokumentuar dhe eshte pare nga policia, avokati mbrojtes, magjistrata dhe gjykates aty ku eshte e zbatueshme. Gjykata informohet me permbajtjen e deklarates ne menyre qe kjo te mirret ne shqyrtim , per shembull, ne marrjen e vendimeve lidhur me rastin dhe denimin.

## Perkrahja e Viktimes

Perkrahja e Viktimes eshte nje shoqate bamirese e ndare nga policia, e cila ofron ndihme dhe perkrahje njerezve qe kane perjetuar krime. Perkrahja e Viktimes ka persona te specializuar per t'u marre me viktimat e krimit, te cilet do t'ju kontaktojne per t'ju siguruar keshilla konfidenciale, informacion apo perkrahje. Polici do t'ju referoj tek Perkrahja e Viktimes sipas deshires tuaj. Eshte me rendsi t'i tregoni oficerit nese **NUK** deshroni t'ju kontaktoj Perkrahja e Viktimes. Ne do t'i kalojme vetem hollesirat e kundervajtjes seksuale, dhunes familjare ose te dhenat e te afermve familjar te viktimes se vrare, nese kemi pelqim per ta bere kete.

## Kompenzim

Nese keni perjetuar humbje, lendim ose demtim si rezultat i krimit, humbje permes vjedhjes, apo demtim te prones; humbje permes mashtrimit; humbje e te ardhurave nga punes; shpenzime mjekesore; shpenzime udhetimi; dhimbje dhe vuajtje; humbje demtim ose lendim te shkaktuar nga vjedhja e makines , ju keni te drejte kompensimi nese dikush eshte arrestuar dhe denuar. Ju duhet ti tregoni policies nese deshironi te kerkoni kompensim,ne menyre qe CPS (prokuroria) te aplikoj per urdher per kompensim. Poashtu, ju duhet t'i jepni policies te dhena te sakta per humbjen, lendimin ose demtimin, dhe sipas mundesise çfaredo prova tjera, sikurse deftesat. Nese jeni lenduar ne krim te dhunshem, ju mund te kerkoni kompensim perms Skemes per Kompensim te Lendimit Kriminal.Per me shume informacion ju lutem vizitoni **www.cica.gov.uk**

## Pas shkuarjes se policise

Nese keni me shume informacion lidhur me incidentin, ju lutem kontaktoni policine duke i telefonuar ne 0845 60 60 222 per te biseduar me qendren lokale te Sherbimit Publik dhe duke e permend numrin refererues te krimit ose incidentit.





# Shenimet

Ju lutem perdorni kete hapesire per te marre shenime per ndonje informacion qe mendoni se eshteil dobishem  per me mbrapa. Ju lutem regjistroni çdo prone te vjedhur, emrat, adresat dhe numrat e telefonit, etj.

# Pyetje tuaja te pergjigjura

## A do te jete i pranishem oficeri?

Varet nga krimi. Ne disa raste – siç eshte vjedhja ne shtepi, krime serioze me dhune apo incidente te urrejtjes – Oficeri gjithmone do te jete i pranishem. Mirepo, ne rastet – siç eshte  vjedhja e bicikletes – prania e oficerit varet nga rrethanat e krimit. Ndonjehere eshte me mire per ju nese mirremi me te dhenat e krimit permes telefonit. Çfaredo te jete rasti, ju gjithmone duhet te merrni nga ne informacion qe ju duhet

## Perse hetuesi i vendngjarjes se krimit nuk me ka vizituar?

Pasi  oficeri i policies te mirret me te dhenat e menjehershme te krimit, ata do te  kerkojne nga hetuesi i vendngjarjes se krimit  t'ju vizitoj. Hetuesi i vendngjarjes se krimit do t'ju merre gjurmet e gishtave, gjurmet e shputave dhe fotografite e vendngjarjes se krimit. Nese ju kane sulmuar ata do t'ju marrin edhe fotografite e lendimeve. Ne disa raste oficeri i cili e ka raportuar  krimin tuaj mendon se nuk do te kete ndonje dobi nga ekzaminimi i analizave mjeko-ligjore. Çfaredo qe te ndodhe, oficeri qe e ka raportuar krimin tuaj duhet t'ju shojegoj kete dhe arsyet pse, dhe duhet t'ju tregoj se çfare duhet te pritni tjeter.

## A me tregoni nese e keni arrestuar ndonjerin dhe se çfare ndodhe me pastaj?

Po, ne do t'ju tregojme  nese dikush eshte arrestuar lidhur me krimin tuaj dhe ne do t'ju freskojme me informata per progresin permes hetimeve. Mirepo, Nese eshte bere nje arrestim ne nuk mund t'ju tregojme derisa ai person te ngarkohet  per ate krim.

## Si ngarkohet personi ose si thirret ne gjyq?

Nese personi i arrestuar lirohet me dorezani dhe ka kushte te imponuara te cilat ndikojne ne ju, ne do t'ju informojme sa me shpejte qe te lirohen. Nese ky person ngarkohet ne do t'ju informojme per proseduren e gjyqit.





## A me kthehet prona?

Per çdo vit ne kthejme  shume artikuj  te prones nese nuk mund t'ua kthejme pronereve legjitim per shkak se nuk kemi marre informacion te mjaftueshem lidhur me artikullin ne kohen e raportimit . Eshte me rendsi te jepni sa me shume te dhena kur raportoni artikujt e humbur ose te vjedhur-duke perfshire edhe numrat serik, prodhimin e artikullit e keshtu me radhe. Nese e rikthejme pronen qe mendojme se ju takon juve ne do t'ju kontaktojme sa me pare per ta identifikuar ate. Ju duhet te na siguroni  deklarata nese prona eshte e juaja. Ne synojme t'ua kthejme ato sa me shpejte, por  ju lutem ju duhet te dini se ne disa raste ne duhet t'i mbajme ato per proces gjyqesor.

## Si mund ta dije se ju nuk mund te beni asgje me shume?

Ne do te bejme çmos per te hetuar krimin tuaj.  Vetem ne rastin kur sosen te gjitha lidhjet e hetimit ne dispozicion  dhe se nuk mund te bejme asgje tjeter, ne do te mbyllim çeshtjen. Ne nuk do te mbyllim çeshtjen pa ju informuar se pari. Mirepo, ndonjehere rasti del ne drite pasi te mbyllet çeshtja, dhe nese ndodhe kjo ne do t'ju kontaktojme juve. Poashtu, nese pas kesaj ne rikthejme ndonej prone ose bjeme ndonje arrestim do t'ju kontaktojme juve gjithashtu.

## Nuk jam i/e pakenaqur me sherbimin e marre nga policia – çfare mund te beje?

Ne perpiqemi te ofrojme sherbim te nivelit te larte per te gjithe ata qe kane kontakt me policine. Mirepo, ne e pranojme se nuk do te jene te gjithe te knaqur  me sherbimin e marre per arsye te ndryshme. Nese nuk jeni te kenaqur me ate se si eshte vepruar me ju, atehere ne duam te dijme. Ju lutem shih faqen11 per hollesira dhe se si te kontaktoni me ne.







## Kush vendos per ndjekje penale?

Sherbimi i Prokurorise (CPS) eshte nje nje agjencion i pavarur pergjegjese per ndjekjen penale te rasteve ne gjyq. CPS-ja vendos per ndjekje penale pas shqyrtimit te evidences te mbeldhur nga policia. CPS-ja do te vazhdoj ndjekjen penale vetem nese ka evidence te mjaftueshme reale per te arrijte denimin dhe nese eshte ne interest e publikut te behet kjo. CPS-ja udhezohet nga Kodi i Prokurorise. Ju mund te merrni nje kopje falas nese e thirrni degen informative te CPS-se ne **020 7796 8000**.

## Si ngarkohet personi ose si thirret ne gjyq?

Pas arrestimit te tyre, personi mund te ngarkohet ne stacion policor , aty mund te mbahen ne paraburgim derisa ne gjykim ose ata do te lirohen me dorezani per te vijuar gjyqin me vone. Si alternative, personi e merre nje thirrije per gjyq qe kerkon te vijoj gjyqin.

Varesisht nga ngarkesa, rastet degjohen ne Gjykaten e Magjistrates ose ne Gjykaten e Kurorese. Kundervajtjet serioze degjohen ne Gjykaten e Kurores. Njesia per Kujdesin e Deshmitarit ju ofron perkrahje dhe keshilla, do t'ju informojne per progresin e çeshtjes tuaj sa here te ka gjykim. Nese keni per te vijuar gjyqin ata ju ndihmojn e per te organizuar aranzhimin e udhetimit, rezervimin e kujdesit per femijen dhe poerkrahjen per viktimen. Ju do te keni rastin te beni nje vizit para gjykimit dhe ne diten e procesit gjyqesor Nepunesi per Kujdesin e Deshmitarit ne gjyq, do te siguroj perkrahje.







## Paralajmerim, qortime, vrejtje e fundit dhe denimi me gjobe per trazira

Nese personi mere paralajmerim, qortim ose verejtje , kjo do t'i leshohet ne stacionin policor, zakonisht nga nje Oficeri me i Larte. Paralajmerimet i jepen te rrituve, kurse qortimet dhe verejtjet e fundit ju jepen kundervajtesve te rinje. Keto zakonisht ju jepen atyre qe nuk kane pasur histori kriminale te perparshme ose se fundi. Te dhenat mbahen ne Kompjuterin Kombetar te Policise dhe regjistrimet mund te ndikojne ne vendimin e ndjekjes penale te metutjeshme, nese personi arrestohet ne te ardhmen. Denimi me gjobe eshte nje denime me te holla i leshuar nga polici; keto mund te leshohen edhe per sjellje joshoqerorere, prishje te rendit public dhe disa llojeve te krimit. Kundervajtesi duhet te paguaj shumen e denimit brenda 28 ditesh, dhe nese nuke paguan denimin do te regjistrohet ne gjyqin e magjistrates.

## Nese jeni deshmitar te krimit

Si deshmitar te krimit nga ju kerkohet te jepni deklarate ne polici, kjo do te perfshije nje vleresim fillestar e nevojave tua si deshmitar. Juve do t'ju ofrojne te ju referojne tek Sherbimi per Deshmitar per perkrahje te metutjeshme çeshtja del ne gjyq. Nese mendoni se jeni ne rrezik nga frikesimi, ju duhet t'ia beni me dije nepunesit te çeshtjes. Ne synojme t'ju freskojme me informacion se paku nje here ne muaj per progresin e çeshtjes suaj ,desira te mbaroj hetimi ose derisa te ngarkohet dikush, te thirret ne gjyq, ose te shqyrtohet çeshtja jashte gjyqit. Njesia per Kujdesin e Deshmitarit do t'ju mbaj te informuar per progresin e çeshtjes tuaj sapo te ngarkohet i pandehuri.

## Ku mund te marre ndihme dhe keshilla?

Ju mund te merrni ndihme dhe perkrahje nga Skema e Perkrahjes per Viktimen. Ata mund t'ju ndihmojne pergjate procedures gjyqesore dhe gjykimit. Numri n e tyre te telefonit mund ta gjeni ne faqen 12.

Per hollesira thirrni **0845 303 0900** dhe pyetni per informacion lidhur me Sherbimin e Deshmitarit. **Nese jeni te pakenaqur**

Ne gjitmone mundohemi te ofrojme sherbim qe siguron informacion te rregullt per njerez per rastet e tyre individuale dhe duke ju dhene atyre informacion te duhur, por ne disa raste ju mund te ndiheni se keni mbetur te zhgenjyer, ose ju deshironi vetem nje ndihme/asistence plotesuese. Ne te shumten e rasteve keto probleme mund te zgjidhen shume lehte, duke biseduar me nepunesin e çeshtjes, me nje mbikqyres ose nje anetar te personelit ne kuader te Qendres se Sherbimit Publik ne stacionet lokale. Ju mund te beni kete duke telefonuar **0845 60 60 222**, dhe te permendni numri e references se krimit ose incidentit.

Nese nuk eshte e mundur te zgjidhet ky problem me telefon, atehere ju mund te flisni personalisht me dike, duke vijuar stacionin policor lokal – ju mund t'i gjeni te dhenat e orarit te punes te stacionit tuaj ne **www.humberside.police.uk**

Nese ne akoma nuk mund te zgjidhim problemin ne nivel te knaqshem, ju mund t'na shkruani e-mail, duke perdorur seksionin per t'na kontaktuar neve ne uebsajt, ose, si alternative, ju mund t'na shkruani ne adresen si vijon:

Dega e Standardit Profesional te Zyres Qendrore te Poliicse se

Humberside, Priory Road,

Kingston Upon Hull.

HU5 5SF.

Ne synojme te pranojme te gjitha korrespondencat e tilla brenda 24 oreve dhe kjo do te mere kohe per te shqyrtuar shqetesimin tuaj ne nje interval qe do t'i plotesoj nevojat tuaja, duke ju mbajtur te informuar .

Veç kesaj Home Office-i publikon Kodin e Viktimes, e cila shpejgon standarded qe mund t'i pritni nga sistemi i drejtesise kriminale.

Thirrni Home Office-in ne **020 7273 4417** per nje kopje falas ose vizitoni uebsajtin: **www.homeoffice.gov.uk/**





# Numra telefoni te dobishem

| | |
|---|---|
| Age Concern | 0800 009966 |
| Childline | 0800 1111 |
| Crimestoppers (to report crime and information anonymously) | 0800 555 111 |
| Cruse Bereavement Care | 0844 477 9400 |
| Disability Living Foundation | 0845 130 9177 |
| Domestic violence refuge | 0870 5995443 |
| Drinkline | 0800 917 8282 |
| Frank (drug advice) | 0800 77 66 00 |
| Help The Aged Seniorline | 0808 800 6565 |
| Hull City Safe | 01482 300 300 |
| Lone Parent Helpline | 0800 0185026 |
| Mencap | 020 7696 5593/5503 |
| Mind | 0845 766 0163 |
| National Debt Line | 0808 808 4000 |
| National Drugs Helpline | 0800 776600 |
| National Missing Persons Helpline | 0500 700700 |
| NSPCC | 0800 800 500 |
| Police Non Emergency number | 0845 60 60 222 |
| Relate | 0845 1304010 |
| Safer Communities East Riding | 01482 391424 |
| Safer Communities North East Lincolnshire | 01472 324944 |
| Safer Neighbourhoods North Lincolnshire | 01724 27327 |
| Samaritans | 0845 7 90 90 90 |
| Shelter 24 hr | 0808 800 4444 |
| Tackling Drugs hotline | 0800 1698994 |
| Victim Support | 0845 30 30 900 |
| Womens Aid | 0845 702 3468 |

